



| | | | |
|--|------------------------------|---------------------------------|--------------------------------|
| Pranuar / Datede Prenjend / Printed Received / Delivered | 30.10.23 | 3 | viti year |
| Organ / Shkalla Organ / Rank | Hi / Prof Hi / Prof No | Shtet / Profes / profesia | Sasia Kategoria Quantity |
| SKMSHCK | 6734 | 2023 | 113 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1133/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1133/2023 të datës 01.09.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër ZSP-Nr.93/2023 dhe Vendimit me numër ZSP.Nr.91/2023 të datës 04.08.2023 të Sekretarës së Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHT si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.1133/2023 e datës 01.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.07/2023 të datës 03.07.2023 në Ministrinë e Drejtësisë në pozitën e punës „Zyrtar i Lartë Ligjor” në Divizionin për Bashkëpunim në Çështjet Penale dhe Civile në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Juridik.

Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë më datë 04.08.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër ZSP-Nr.93/2023 përmes së cilit zyrtarën E.B e ka caktuar si Zëvendësueses e Udhëheqëses të Divizionit për Hartimin dhe Negocimin e Marrëveshjeve Bilaterale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe Vendimin me numër ZSP-Nr.91/2023 përmes së cilit zyrtarin A.B e ka caktuar si Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Gjyqësor Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimet me numër ZSP-Nr.93/2023 dhe ZSP-Nr.91/2023 të datës 04.08.2023, më datë 01.09.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.09.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Ministria e Drejtësisë. Ndërsa Këshilli më datë 08.09.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës.

Me Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 6530/2023 të datës 13.09.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1133/2023 të datës 25.05.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa me numër protokollit 5913/2023 e datës 01.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë e vitit 2008/09; Vendimin me numër ZSP-Nr.93/2023 të datës 04.08.2023; Vendimin me numër ZSP-Nr.91/2023 të datës 04.08.2023; E-mail i datës 01.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 08.09.2023; E-mail i datës 08.09.2023; E-mail i datës 04.09.2023; Akt Emërimit e datës 24.04.2017 për E.B; Kërkesën për punësim të datës 27.02.2017; Vërtetimi për pranimin e aplikacionit i datës 27.02.2023; Akt Emërimit me numër AE.Nr. 02/2022 të datës 18.07.2022 për A.B; Konkurs për lëvizje brenda kategorisë i datës 10.06.2022; Akt Emërimit me numër AE.Nr. 07/2023 të datës 03.07.2023; Konkurs lëvizje brenda kategorisë me numër reference Nr.RN00011670 i datës 07.06.2023; E-mail i datës 07.08.2023; Vendimi me numër protokollit 6530/2023 i datës 13.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e palejuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.07/2023 të datës 03.07.2023 në pozitën e punës „Zyrtar i Lartë Ligjorë” në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar/Divizioni për Bashkëpunim në Çështjet Penale dhe Civile.

Ankuesi në ankesën me numër protokollit 5913/2023 të datës 01.09.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë me rastin e Nxjerrjes së Vendimeve me numër ZSP-Nr.93/2023 dhe ZSP-Nr.91/2023 të datës 04.08.2023, ka bërë shkelje procedurale dhe materiale, për shkak se kandidatët e caktuar për zëvendësues nuk e kanë përvojën e mjaftushme të punës për tu caktuar si Zëvendësues të Udhëheqësve të Dizivizioneve si dhe caktimi i tyre si zëvendësues të Udhëheqësve ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...”*.

Se kush konsiderohet palë në procedurën administrative Kolegji i'u referuar nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e*

interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër ZSP-Nr.93/2023 dhe Vendimi me numër ZSP-Nr.91/2023 të datës 04.08.2023 të nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë e që ankuesi i ka kontestuar me ankesë nuk cenojnë ndonjë të drejtë apo interes juridik të ankuesit, gjegjësisht ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimeve të lartë cekura, si rrjedhojë bazuar në këtë konstatim si dhe referuar nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1,2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankueses konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1133/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.